



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 25.06.2014

**Për:** Goran Rakic, *Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore*

**Lënda:** Punimet ilegale të ndërtimit të barrikadave dhe pengesat për lëvizjen e lirë në urën e Lumit "Ibër" në Mitrovicë

I nderuar Kryetar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas konstatimit të gjendjes në terren për zhvillimin e punimeve ilegale të ndërtimit të barrikadave në urën e Lumit "Ibër", **konstaton se:**

- Ndërtimi i barrikadave në urën e Lumit "Ibër" përbënë shkelje të lirisë së lëvizjes së qytetarëve të garantuar me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit të datës 19 prill 2013, si dhe Marrëveshjen e Brukselit të datës 2 korrik 2011.
- Punimet e ndërtimit të barrikadave në urën e "Ibrit" nga autoritet lokale të Komunës së Mitrovicës Veriore përbëjnë shkelje të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, Ligjit Nr.03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë nr. 2003/11, Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim.
- Bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale komuna është përgjegjëse për planifikimin urban dhe rural. Me këtë rast, Komuna e Mitrovicës së Veriut nuk ka miratuar Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të hollësishme siç kërkohet me nenin 5 (pika 1.2) të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.
- Punimet ilegale në urën e Lumit "Ibër" janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim. Sipas nenit 14 të këtij ligji pjesëmarrësit në ndërtim nuk mund të zhvillojnë asnjë aktivitet ndërtimor pa leje ndërtimore dhe në kundërshtim me parimet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.
- Punimet në urën e Lumit "Ibër" nuk burojnë nga planet investuese-kapitale të përcaktuara në buxhetin e komunës, ashtu siç parashihet me nenin 40 (pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

- Sipas nenit 3 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, “rruga publike është për përdorim të përgjithshëm dhe sferë interesi për Kosovën”. Ndërsa, sipas nenit 2 (paragrafi 4.2, pika b) të Ligjit Nr.03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë Nr.2003/11 rruga publike përbëhet ndërmjet tjerash prej “objekteve ndërtimore të rrugës (ura, viadukte, lëshesa, tunele, galerive, mure mbrojtëse etj.). Në pajtim me nenin 20 të këtij ligji ndalohet “të dëmtohet rruga publike, objektet e rrugës, pajisjet rrugore, të ndryshohet forma dhe të zihet sipërfaqja e rrugës ose e pjesëve që i takojnë”.
- Gjithashtu neni 22 i Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët ka përcaktuar se bllokimi i rrugëve publike pa arsye përmes vendosjes së ndonjë materiali që pengon, ndërprejë, shkurton ose në mënyrë tjetër dëmton rrugën publike, përbën shkelje të dispozitave të këtij ligji.


Duke marrë parasysh shkeljet e konstatuara më lartë, **KËRKOJMË** nga kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore të ndërmarrë masat e menjëhershme për zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet për heqjen e barrikadave në urën e Lumit “Ibër”, për të krijuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e rrugëve publike pa cenuar dhe kufizuar lirinë e lëvizjes të garantuar me Kushtetutë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Komuna e Mitrovicës Veriore të ushtrojë kompetencat në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**

Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së



**Kopje:** Hashim Thaçi, Kryeministër i Republikës së Kosovës  
Edita Tahiri, Zëvendëskryeministër e Republikës së Kosovës  
Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Arkivit të MAPL-së